

Hyrje

Procesi i Stabilizim Asociimit për Ballkanin Perëndimor është politik kyçe e BE-së për Ballkanin Perëndimorë, me qëllim të anëtarësimit të tij në BE. Procesi është lansuar në qershor 1999 dhe rikonfirmuar në Samitin e Selanikut në qershor 2003.

Kosova ka qenë pjesë e procesi integrues të Ballkanit Perëndimor qysh nga viti 2002, kur ka filluar procesi i Mekanizmit Përcjellës të procesit të Stabilizim Asociimi. Në vitin 2009, ky proces është avancuar në Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit.

Sidoqoftë, asnjëri nga këto dy mekanizma nuk kanë qenë instrumentet zyrtare të Bashkimit Evropian për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. BE-ja, për shkak 5 vendeve që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, nuk ka qenë në gjendje të ofroj Kosovës proces të njëjët anëtarësimi sikur për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ky proces për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor ka filluar me lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimi (MSA). MSA-ja përfaqëson marrëveshjen më të rëndësime ligjore dhe politike e cila është themel i procesit anëtarësimit në BE.

Në vitin 2012, BE ka vendosur të përgatit Studimin e Fizibilitetit për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Studimi konfirmoj se Kosova është kryesisht e gatshme të fillon negociatat për MSA. Për të filluar negociatat, Kosova duhet të përmbushë 4 kriteret shtesë në sundimin e ligjit, tregti, reformën e administratës publike dhe mbrojtjen e minoriteteve.

Në prill 2013, Komisioni Evropian konkludoj se Kosova i përmbushi 4 kriteret dhe rrjedhimisht në korrik 2013 Këshilli dha dritën e gjelbër për nisjen e negociatave për MSA.

Procesi negociator ka filluar me 28 tetor 2013, dhe rrjedhimisht janë mbajtur 3 takime në nivel të Kryenegociatorëve dhe dhjetëra takime të grupeve teknike. Procesi negociator u përmbyll me 2 maj 2014.

Me 25 korrik 2014 marrëveshja është inicializuar, ndërsa me 22 tetor 2015 MSA u miratua në Këshillin e BE-së.

Nënshkrimi i MSA-së u bë me 27 tetor 2015 në Strasburg. Kuvendi i Republikës së Kosovës ratifikoj Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimi me 2 nëntor 2015.

1. Çfarë është Marrëveshja Stabilizim Asociimi?

MSA është marrëveshje ndërkombëtare e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian qëllimi i së cilës është themelimi i marrëdhënieve formale dhe kontraktuale ndërmjet dy palëve me qëllim të anëtarësimit të Kosovës në BE.

Përmes MSA themelohet një Asociacion mes Kosovës dhe BE i cili ka qëllim që vendit tonë t'i ofrohet:

- Përkrahje për përforcimin të demokracisë dhe sundimit të ligjit.
- Përkrahje për stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional, si dhe stabilizimin e rajonit.
- Kornizë e përshtatshme për dialogun politik që do të mundësojë zhvillimin e marrëdhënieve të afërta politike mes palëve.
- Përkrahje në zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, nëse rrethanat objektive lejojnë, edhe përmes përafrimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës me atë të BE-së.
- Përkrahje për kompletimin e transicionit në ekonomi funksionale të tregut.
- Përkrahje në promovimin e marrëdhënieve të mirëfillta ekonomike dhe zhvillim gradual të tregut të përbashkët në mes vendit tonë dhe BE-së.

- Përkrahje në përforcimin e bashkëpunimit rajonal në të gjitha fushat që mbulohen nga MSA.

2. Cila është përmbajtja e MSA-së?

MSA përmban MSA përmban 597 faqe, në 144 nenedhe X tituj:

- Preambula;
- Neni 1;
- Titulli I, Parimet e Përgjithshme;
- Titulli II, Dialogu Politik;
- Titulli III, Bashkëpunimi Rajonal;
- Titulli IV, Lëvizja e Lirë e Mallrave;
- Titulli V, Themelimi i ndërmarrjeve, Ofrimi i Shërbimeve dhe Lëvizja e Kapitalit;
- Titulli VI, Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me *Acquis* të BE-së, Zbatimi i Legjislacionit dhe Rregullat e Konkurrencës;
- Titulli VII, Liria, Siguria dhe Drejtësia;
- Titulli VIII, Politikat e Bashkëpunimit;
- Titulli IX, Bashkëpunimi Financiar;
- Titulli X, Dispozitat Institucionale, të Përgjithshme dhe Përfundimtare.

Po ashtu, pjesë përbërëse e marrëveshjes janë 7 shtojcat dhe 5 protokolle, qëllimi i së cilave është sqarimi apo detajizimi i mëturjshëm i neneve të ndryshme të marrëveshjes:

SHTOJCAT

- Shtojca I (Neni 23), Tarifat koncesionare të Kosovës për produktet industriale të BE-së;
- Shtojca II (Neni 28), Përkufizimi i produkteve të "*mishit të viçit*";
- Shtojca III (Neni 29), Tarifat koncesionare të Kosovës për produktet bujqësore të BE-së;
- Shtojca IV (Neni 31), Koncesionet e BE-së për produktet e peshkut të Kosovës;
- Shtojca V (Neni 32), Tarifat koncesionare të Kosovës për peshkun dhe produktet e peshkut të BE-së;
- Shtojca VI (Neni 50), Themelimi: Shërbimet financiare;
- Shtojca VII (Neni 77), Të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

PROTOKOLLET

- Protokollu I (Neni 27), Tregtia mes BE-së dhe Kosovës së produkteve të përpunuara bujqësore;
- Protokollu II (Neni 30), Verërat, pijet alkoolike dhe verërat e aromatizuara;
- Protokollu III (Neni 46), Përkufizimi i termit "*origjina e produkteve*";
- Protokollu IV (Neni 104), Asistenca reciproke administrative në çështjet doganore;
- Protokollu V (Neni 136), Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

3. Çfarë është rëndësia politike e MSA-së?

- Marrëdhënia ndërmjet Kosovës dhe BE-së transformohet nga marrëdhënie e bazuar në deklaratat e një anshme politike, në marrëdhënie kontraktuale me obligimet e dy anshme.
- Kosova është tani pjesë e procesit formal të anëtarësimit, njëjtë sikur të gjitha vendet e rajonit.
- Marrëveshje bazë e marrëdhënieve tona me Bashkimin Evropian deri në aktin e anëtarësimit.
- BE-ja merr obligim të realizon perspektiven Evropiane të Kosovës, duke integruar Kosovën në BE në harmoni me kriteret e Kopenhagës të vitit 1993.
- Njohja e entitetit ligjor dhe politik të Kosovës si palë në skenën evropiane dhe ndërkombëtare përmes një traktatit ndërkombëtarë.
- Kosova dhe BE-ja zyrtarizojnë bashkëpunimin në të gjitha fushat e shoqërisë tonë, duke marr obligime për përmbushjen e standardeve Evropiane dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së.
- Kosova dhe BE-ja do të avancojnë bashkëpunimin institucional, përmes krijimit të trupave të përbashkët ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe BE-së:

- Këshilli i Stabilizim-Asocimit – trup më i lartë, i cili do të ketë fuqi vendim-marrëse për zbatimin e MSA-së. Vendimet e Këshillit janë obliguese;
- Komiteti i Stabilizim-Asocimit–trup përgjegjës për mbikëqyrjen operacionale të zbatimit të MSA-së;
- Nën-komitetet e Stabilizim-Asocimit – trupat e veçanta në nivel të ekspertave, përgjegjës për mbikëqyrjen e MSA-së në nivel të sektorëve; dhe
- Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asocimit – forum i shkëmbimit të informacionit ndërmjet deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe Parlamentit Evropian.
- Kosova do të ketë përkrahje për pjesëmarrje në komunitetin ndërkombëtar demokratik.
- Kosova do të ketë përkrahje nëpërfundim me Masat e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe Sigurisë.
- Zhvillimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore në kuadër të Ballkanit Perëndimor .
- Përafrimi i legjislacionit.

4. Çfarë është rëndësia ekonomike e MSA-së?

- Zhvillimi gradual i zonës së tregtisë së lirë ndërmjet Kosovës dhe BE-së brenda 10 vite.
- Liberalizimi gradual i tregut të Kosovës për produktet e BE-së.
- Qasja e plotë e produkteve të Kosovës në BE.¹
- Qasje e bizneseve kosovare në një treg prej mbi 500 milion banorësh.
- Qasje e qytetarëve në një gamë më të madhe të produkteve dhe shërbimeve më të mira dhe me çmime më të lira.
- Zhvillimi, revitalizimi dhe modernizimi i ekonomisë drejt përfundimit të tranzicionit në ekonomi funksionale të tregut.
- Përafrimi i legjislacionit në fushën e ekonomisë.
- Përforsimi i sundimit të ligjit në fushën e ekonomisë.
- Përafrimi i politikave ekonomike me ato të Unionit Monetar dhe Ekonomik.
- Krijimi i institucioneve ekonomike të reja dhe përforsimi i institucioneve ekonomike ekzistuese.
- Përmirësimi i mjedisit afarist.
- Rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve përmes qasjes në asistencë financiare dhe teknike të ofruar nga BE dhe përmes bashkëpunimit në pranimin më të shpejtë të know-how dhe në qasjen në teknologji të reja.
- Bashkëpunim në hulumtime dhe zhvillim teknologjik.
- Përkrahje në përforsimin e sektorit bankar, të sigurimeve dhe të shërbimeve financiare.
- Rritja e investimeve të huaja direkte.
- Rritja e investimeve vendore.
- Rritja e konkurrencës dhe stimulimi i eksportit.
- Përafrimi i legjislacionit në fushën e punësimit.
- Përkrahje në arritjen e standardit adekuat të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në përputhje me Procesin dhe Deklaratën e Bolonjës.
- Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe materiale të qytetarëve.
- Krijimi i vendeve të reja të punës.
- Përkrahje për stabilitet makroekonomik në rast nevojë përmes asistencës financiare në formë të granteve dhe kredive.

¹Nga viti 2000, Kosova ka përfituruar nga Masat Autonome Tregtare të BE-së të cilat kanë mundësuar eksportin e të gjitha produkteve të Kosovës në BE. Sidoqoftë, këto masat kanë qenë njëanshme dhe kanë mundur të ndryshohen në çfarëdo momenti.

5. Themelimi i ndërmarrjeve, Ofrimi i Shërbimeve dhe Lëvizja e Kapitalit

- Ndërmarrjet e Kosovës, degët dhe filialet e tyre do të mund të themelohen dhe vepronë në territorin e BE-së duke u trajtuar në mënyrë të njëjtë sikur ndërmarrjet e BE-së. E njëjta e drejtë do të vlej anasjelltas edhe për ndërmarrjet e BE-së që do të vendosen dhe do të vepronë në territorin e Kosovës.
- Ndërmarrjet e BE-së do të kenë të drejtë për të përdorur dhe marrë me qira pasuri të patundshme në Kosovë. Pas pesë viteve nga hyrja në fuqi të MSA-së Marrëveshjes, ndërmarrjet e BE-së do ta kenë gjithashtu të drejtën e përvetësimit dhe gëzimit të drejtave të pronësisë mbi pasuritë e patundshme sikurse ndërmarrjet Kosovare në BE.
- Ndërmarrjet e vendosura në territorin e palës tjetër do të kenë të drejtë të punësojnë në degët apo filialet e tyre shtetas të palës tjetër, me kusht që personat e tillë të jenë personel kyç të punësuar në atë ndërmarrje, degë apo filiale. Personel kyç janë personat e transferuar brenda ndërmarrjes dhe të cilët punojnë në pozita drejtuese të ndërmarrjes ose persona të cilët zotërojnë njohuri të veçanta që janë thelbësore për ndërmarrjen.
- Hapat e nevojshëm për ndjekjen e veprimtarive profesionale, njohja reciproke e kualifikimeve dhe hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i ofruesve të shërbimeve të cilësuar si të vetëpunësuar, në territorin e palës tjetër, do të rregullohen në mënyrë progresive.
- Nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, Kosova dhe BE do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investimet e drejtpërdrejta nga ndërmarrjet e krijuara në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe investimeve të bëra në përputhje me MSA-në, si dhe likuidimin ose riatdhesimin e këtyre investimeve dhe të çdo përfitimi që rrjedh prej tyre.
- Brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, Kosova duhet t'i ofroj trajtim të barabartë me shtetasit e Kosovës për shtetasit e BE-së që blejnë pasuri të patundshme në territorin e saj.

6. Përafrimi i legjislacionit të Kosovës me Bashkimin Evropian

- Kosova merr përsipër të përafrojë legjislacionin ekzistues dhe legjislacionin e ardhshëm në mënyrë graduale me legjislacionin e BE-së.
- Përafrimi fillon nga hyrja në fuqi e marrëveshjes dhe shtrihet gradualisht në të gjitha elementet e legjislacionit të BE-së brenda periudhës dhjetë vjeçare.
- Në fazën e parë, rëndësi i jepet përafrimit të legjislacionit bazë të BE-së për fushat e tregut të brendshëm, aspekteve tregtare dhe fushave të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Kjo pjesë e marrëveshjes rregullon edhe:

- Konkurrencën në treg - ku ndalohen të gjitha praktikat dhe marrëveshjet që parandalojnë, kufizojnë ose pengojnë konkurrencën përfshirë edhe kontrollin dhe monitorimin e ndihmës shtetërore.
- Ndërmarrjet publike të cilat kanë status të ofrimit të shërbimeve të interesit të përgjithshëm, brenda tri viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes duhet të zbatojnë rregullat e konkurrencës në harmoni me parimet e Traktatit për Funkcionimin e BE deri në masën që nuk pengon ofrimin e këtyre shërbimeve.
- Mbrojtjen efektive të pronësisë intelektuale - Kosova brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes duhet të sigurojë nivel të ngjashëm të mbrojtjes së pronësisë intelektuale, industriale dhe komerciale me atë në BE.
- Hapjen e dhënies së kontratave përmes prokurimit publik bazuar në parimet e reciprocitetit dhe mos-diskriminimit si objektiv i dëshiruar i të dy palëve. Ndërmarrjet e Kosovës do të kenë trajtim të barabartë në procedurat për dhënie të kontratave në BE. Ndërsa, në Kosovë ndërmarrjet e Kosovës do të janë pozitivisht të diskriminuara në çmimin e ofertuar:
 - o 15% deri në fund të vitit të dytë;
 - o 10% deri në fund të vitit të tretë;
 - o 5% deri në fund të vitit të katërt;
 - o 0% deri në fund të vitit të pestë.

7. Detajet e pjesës tregtare të MSA-së

- Të gjitha produktet industriale dhe bujqësore të Kosovës do të eksportohen në BE pa tarifë doganore.
- Sidoqoftë, kuotatat e caktuara janë të vendosura, si për shembull tarifa doganore në BE nuk vlen deri në volumin prej 15 tonë për vit për peshkun troftë. Kuota për krap është 20 tonë në vit. Pas kësaj sasive, aplikohet tarifa doganore e BE-së.
- Është rritur kuota e eksportit të verës nga 20,000 hekto litra në 50,000 hekto litra.

8. Koncesionet e BE-së për prodhimet industriale të Kosovës

- Të gjitha produktet industriale të Kosovës do të eksportohen në shtetet e BE-së me tarifë doganore zero (0).

9. Koncesionet BE-së për produktet bujqësore të Kosovës

- Të gjitha produktet bujqësore të Kosovës do të eksportohen në shtetet e BE-së me tarifë doganore zero (0).

10. Koncesionet e Kosovës ndaj produkteve industriale të BE-së

- Kosova do të shfuqizojë tarifën doganore për 3,023 linja tarifore të produkteve industriale me hyrjen në fuqi të MSA. Këto produkte nuk prodhohen në Kosovë dhe ne nuk kemi kapacitete për prodhimin e tyre.
- 1,131 produkte do të liberalizohen gradualisht brenda një periudhë prej 5 vitesh (*pajisjet televizive, telefonat mobil, printerë, pajisje për bankënota, kamera për incizim dhe kamerat digjitale, kripë, kuarc, mermer, llaç, çimento, disa mallra farmaceutike dhe kirurgjikale, parfume, vajra dhe kozmetikë, sapun, gomë natyrore, artikuj lëkure, materiale tekstili dhe pëlhura, pllaka qeramike, prodhime gresi, porcelan, disa metale dhe metale të çmuar, mjete për punë dore, pajisje mekanike dhe shtëpiake, etj*).
- 925 produkte do të liberalizohen gradualisht brenda një periudhe për 7 vjet nga hyrja në fuqi e MSA-së (*ngjyra, kozmetikë, parfume, produkte plastike, artikuj shtëpiake dhe të tualetit, artikuj higjienike dhe farmaceutike, artikuj druri, artikuj letre, artikuj të ndryshme tekstili, veshje, produkte çeliku dhe hekuri, gypa dhe tuba, rezervuarë, fuçi, pajisje shtëpiake, automjete motorike, artikuj elektrikë, pajisjet kompjuterike, etj*).

11. Koncesionet e Kosovës ndaj produkteve bujqësore të BE-së

- Kosova, që nga hyrja në fuqi e MSA-së, do të shfuqizojnë tarifën doganore për 1,044 nga 2,564 produkte bujqësore nga BE-ja. Ndërsa 164 produkte bujqësore të BE-së tashmë janë të liruara nga tarifa doganore me Ligjin Ligji Nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruara nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor.
- 14 produkte kanë qenë të pa-negociueshme dhe nuk janë përfshirë në marrëveshje, gjë që do të thotë se tarifa Kosovare do të mbetet e njëjtë (10%) për ato produkte (që kryesisht përfshijnë produkte të *qumështit, krem, jogurt, patate, molle, verë*).
- 12 produkte shumë të rëndësishme për prodhimin bujqësor të Kosovës (8 bujqësore dhe 4 të përpunuara bujqësore) janë mbrojtur dhe tarifa doganore do të reduktohet gradualisht brenda një periudhe 10 vjeçare nga hyrja në fuqi e marrëveshjes (*produkte të qumështit, fruta dhe perime, ujë, birra dhe produkteve të grurit*).
- 256 produkte sensitive bujqësore (180 bujqësore dhe 76 të procesuara bujqësore) të rëndësishme për fermerët e Kosovës do të jenë të mbrojtura dhe tarifa doganore e tyre do të reduktohet gradualisht brenda një periudhe 7 vjeçare (*lëngje frutash si lëng molle, o, luleshtrydhe, kumbulla etj, xhem dhe marmelatë, patate, miell, mish dhe mish i shpezëve, uthull si dhe djathë, etj*).
- 451 produkte (prej tyre 353 bujqësore dhe 98 produkte të proceduara bujqësore) do të lirohen nga detyrimet doganore gradualisht brenda një periudhe prej 5 viteve (*produktet mishit të bagëtive, pulave, qumësht dhe krem, produkte nga yndyra e qumështit, lule me petale për përdorim, qepë, hudhër, disa perime, disa fruta të caktuara dhe produkte të familjes së arrave, produkte të kafesë, çaj, biber, vanilje, oriz, drithëra, vaj, fruta si dardha, rrush, manaferrat, pjeshkë, lëngje frutash, etj*).

12. Koncesionet e Kosovës ndaj BE-së për produktet e peshkut

- Me hyrjen në fuqi të MSA-së, Kosova do të shfuqizojë tarifën doganore për 487 produkte të peshkut.
- Sa i përket troftës, tarifa do të hiqet gradualisht për një periudhë 7 vjeçare, ndërsa për krapëgradualisht për 5 vite.

13. Obligimet e veçanta lidhur me çështjet tregtare

- **Ngrirja e masave doganore "Standstill"** - MSA parandalon të dy anë që të marrin masa të reja doganore apo të risin ato ekzistuese.
- **Ndalesa e diskriminimit fiskal** - MSA parandalon të dy anë që të marrin masa të natyrës së brendshme fiskale të cilat në çfarëdo mënyre diskriminojnë produkte të palës tjetër.
- **E drejta për marrëveshje të tjera doganore** - MSA njeh marrëveshje tjera doganore të dy palëve apo mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve të tjera, përderisa ato nuk përbejnë shkelje të dispozitave të MSA-së.
- **Antidamping dhe subvencionet** - MSA parasheh të drejtën të merr masa tregtare kundër konkurrencës jo të drejtë, në harmoni me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë.
- **Monopolet shtetërore të karakterit komercial** - Me hyrje në fuqi të MSA-së, Kosova do të siguron trajtim të barabartë të furnizimit dhe shitjes së mallrave nga ana e monopoleve shtetëror të karakterit komercial.
- **Kufizimet e lejuara** - marrëveshjet lejohen vendosjen e kufizimeve në zbatimin e dispozitave të MSA-së në bazë të kërcënimit ndaj sigurisë dhe interesit publik, moralit publik, mbrojtjes së jetës së qytetarëve, kafshëve dhe bimëve, etj.
- **Dispozitat mbrojtëse** - MSA lejon marrjen e masave mbrojtëse në ato raste kur tregtia me një apo më shumë produkt shkakton:
 - o Dëmtim serioz industrisë së caktuar ose çrregullim për ndonjë sektor të ekonomisë së një pale;
 - o Ndërhyrje në ekonomik të cilat kanë pasojat serioze në kuadër të regjioni të një pale.

14. Kur do të hy në fuqi MSA-ja?

Në bazë të nenit 144 të MSA-së, marrëveshja do të hyn në fuqi dy (2) muaj pas përfundimit të procedurave ratifikuese të të dy palëve.